



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AVOKATURA E SHETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 2719/18 Prot

Tiranë më, 10. 10. 2014

KOMISIONI I NDJEKJES SË PROCEDURAVE

Në mbështetje të nenit 18, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, Kreut III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 08.04.2009 “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”;

I ngritur mbi bazën e Urdhrit nr. 169, datë 10.10.2014 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit hartoi këtë

FTESË PËR NEGOCIATA

I. AUTORITETI KONTRAKTOR

Avokatura e Shtetit
Adresa: Blv. Zogu I,
Ministria e Drejtësisë, kati 6,
Tiranë, Shqipëri

Person kontakti:

Zj. Brunilda Lilo
Avokate Shteti
brunilda.lilo@avokaturashtetit.gov.al
+355 4 22 53 544
Kryetare e Komisionit për Ndjekjen e Procedurave

Znj. Alma HICKA
Avokat i Përgjithshëm i Shtetit
alma.hicka@avokaturashtetit.gov.al

II. OBJEKTI I KONTRATËS

Asistenca dhe përfaqësimi i Ministrisë së Financave/Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në zhvillimin e procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes me shoqërinë S2 Albania SH.P.K. dhe Rapiscan Systems Inc (“**Mosmarrëveshja**”), bazuar në Kontratën e Koncesionit datë 10 prill 2013, “Për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit”.

Asistenca përfshin vlerësimin e situatës juridike, përfaqësimin përpara arbitrazhit ndërkombëtar dhe asistencën në rast negociatash.

III. HISTORIKU I ÇËSHTJES

A. Historiku

Më 10 Prill 2013 Ministria e Financave dhe shoqëria Rapiscan System (“Rapiscan”) nënshkruan Kontratën e Koncesionit “Për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteinerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit” (“**Kontrata**”). Sipas dispozitës 5.1 të Kontratës Rapiscan i transferoi detyrimet e veta shoqërisë S2 Albania Sh.p.k. Pavarësisht nga ky transferim, Rapiscan vazhdon të jetë përgjegjës sipas Kontratës, si garantues i të gjithë detyrimeve të ndërmarra nga S2 Albania SH.P.K.

Në bazë të Kontratës, Rapiscan dhe S2 Albania SH.P.K. (Paditësit) do të krijojnë ‘një sistem funksional të plotë për skanimin e konteinerëve dhe mjeteve të tjera në pikat e hyrjes dhe daljes në Republikën e Shqipërisë’ dhe do të sigurojnë shërbimet përkatëse për një periudhë prej 15 vitesh.

Sipas pretendimit, Paditësit kanë përmbushur të gjithë detyrimet e tyre sipas Kontratës, ndërsa i Padituri ka kërkuar të argumentojë që Kontrata është nul dhe e pavlefshme, duke qenë kështu, në shkelje të Kontratës. Si përfundim, ka lindur një mosmarrëveshje sipas Kontratës.

Më 14 Gusht 2014 Rapiscan dhe S2 Albania SH.P.K. depozituan pranë Sekretariatit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) Kërkesën për Arbitrazh. Shuma e pretenduar prej tyre është **US \$ 359,000,000.00**.

B. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve – Dispozita e Arbitrazhit

Neni 21.15 I Kontratës së Koncesionit (“ Ligji rregullues dhe vendi”) parashikon:

“Marrëveshja rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë pa rënë ndesh me dispozitat ligjore. Çdo lloj mosmarrëveshje që rrjedh ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të ketë të drejtë për t’iu drejtuar Arbitrazhit Ndërkombëtar (ICC) me kusht që pala tjetër duhet të

pajiset me njoftim me shkrim lidhur me këtë referim të mosmarrëveshjes. Mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

- a. *Numri i arbitrave do të jetë tre (3);*
- b. *Arbitrat do të caktohen në përputhje me rregullat e Arbitrazhit Ndërkombëtarl;*
- c. *Vendi i arbitrazhit do të jetë Viena, Austria;*
- d. *Gjuha e përdorur në arbitrazh do të jetë gjuha Angleze”*

Gjithashtu, në lidhje me procedimin e arbitrazhit, dëshirojmë t’iu informojmë lidhur me sa më poshtë:

- i) *Kërkesa për Arbitrazh është marrë nga i Padituri më 26 Gusht 2014;*
- ii) *I Padituri, nëpërmjet caktimit të anëtarit të tribunalit të arbitrazhit, kërkoi një shtesë afati prej 30 ditësh për të paraqitur Përgjigjen e tij ndaj Kërkesës për Arbitrazh;*
- iii) *Paditësit kanë caktuar si anëtar të tribunalit të arbitrazhit **Audley Sheppard të Clifford Chance;***
- iv) *I Padituri ka caktuar si anëtar të tribunalit të arbitrazhit **Brigitte Stern;***
- v) *Palët kanë dakordësuar për të patur Presidentin e tribunalit të Arbitrazhit të zgjedhur nga anëtarët e tribunalit;*
- vi) *Termet e Referencës nuk janë hartuar ende;*
- vii) *Data e caktuar për paraqitjen e Përgjigjes ndaj Kërkesës për Arbitrazh është më 27 Tetor 2014.*

IV. DETYRAT E AVOKATIT APO ZYRËS SË AVOKATISË

- A. Të studiojë në tërësi kontratën, korrespondencën dhe çdo dokument tjetër në lidhje me Kontratën;
- B. Të bëjë vlerësimin e situatës juridike ekzistuese midis palëve, të përgatisë strategjinë për përfaqësimin e Ministrisë së Financave/Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në procesin e arbitrazhit, duke u konsultuar me Avokaturën e Shtetit;
- C. Të bashkëpunojë me ekspertin/ekspertët e përzgjedhur nga Ministria e Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për vlerësimet e ndryshme teknike dhe financiare, përpara dhe gjatë procesit të arbitrazhit;
- D. Të paraqesë parashtrimet, komunikimet apo çdo dokument tjetër tribunalit brenda afateve të caktuara, të marrë pjesë në seancë dëgjimore si dhe të përgatisë dëshmitarët, ekspertët dhe të kryejë çdo veprim tjetër procedural me qëllim realizimin e mbrojtjes;

- E. Të bëjë vlerësimin e ligjit shqiptar si ligj i zbatueshëm i Kontratës së Koncesionit, në bashkëpunim me nënkontraktorë të përzgjedhur nga avokati apo zyra e avokatisë dhe nën përgjegjësinë e tij/saj;
- F. Të asistojë Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave)/Avokaturën e Shtetit në rast negociatash;
- G. Të kërkojë të gjithë autorizimet apo akt-përfaqësimet e nevojshme për realizimin e Shërbimit;
- H. Të raportojë me shkrim mbi veprimet dhe procedurat e ndërmarra sa herë t'i kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Avokatura e Shtetit;
- I. Të kryejë çdo veprim dhe të ofrojë çdo shërbim tjetër të arsyeshëm me qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Ministrisë së Financave në këtë Mosmarrëveshje.

V. KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E AVOKATIT APO ZYRËS SË AVOKATISË

A. Kriteret e Përgjithshme:

- 1. Avokati apo zyra e avokatisë të jetë i/e specializuar në arbitrazh ndërkombëtar;
- 2. Avokati apo zyra e avokatisë të jenë të besueshëm dhe me reputacion në fushën e veprimtarisë sipas renditjeve të guidave kryesore në fushën e së drejtës.
- 3. Avokati apo zyra e avokatisë të ketë përvojë përfaqësimi në mosmarrëveshje koncesionare.

B. Kriteret e Veçanta:

- 1. Avokati apo zyra e avokatisë të jetë në gjendje të demonstrojë raste të mëparshme suksesi, të paktën 2, në mosmarrëveshje në fushën e kontratave koncesionare;
- 2. Avokati apo zyra e avokatisë duhet të ketë jo më pak se 5 vite eksperiencë pune;
- 3. Avokati apo zyra e avokatisë duhet të provojë se ka përvojë në përfaqësimin në arbitrazhin ndërkombëtar sipas rregullave të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (International Chamber of Commerce – ICC).

Vlerësimi i kriterëve të mësipërme të shprehura në pikë është si më poshtë vijon:

Kriteret për përzgjedhjen	Numri i pikëve
1.Specializimi në arbitrazhin ndërkombëtar	20
2.Besueshmëria/Reputacioni	15
3.Përvojë përfaqësimi në mosmarrëveshje koncesionare	15
4.Raste të mëparshme suksesi në kontrata koncesionare	10
6.Përvojë përfaqësimi në arbitrazhin ndërkombëtar sipas rregullave të ICC	10

Vlerësimi i kriterëve financiare të shprehura në pikë është si më poshtë vijon:

Kriteret financiare	Numri i pikëve
1.Çmimi i ofruar / shpenzimet	30

VI. INFORMACIONI DHE DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQITET NGA OFERTUESIT

A. Informacione:

1. Prezantimi i Zyrës së Avokatisë dhe detajet e kontaktit;
2. CV e stafit të angazhuar për realizimin e Shërbimit;
3. Të demonstrojë aftësitë dhe përvojën në realizimin e Shërbimeve me objekt të ngjashëm.
4. Përshkrim të shkurtër të metodologjisë, veprimeve dhe afateve për ofrimin e Shërbimit.

B. Kopje të dokumenteve të mëposhtme:*

1. Vërtetimi i licensimit për ofrimin e shërbimeve juridike;
2. Vërtetimi se zyra e avokatisë ekziston rregullisht sipas ligjeve në fuqi dhe se nuk ka ndonjë procedurë likuidimi, falimentimi, disiplinore apo tjetër kundër saj që mund të çënojë ofrimin e Shërbimeve;
3. Deklaratë se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit;

C. Çmimi

Çmimi për ofrimin e shërbimit duhet të shprehet në formë e një tarife me tavan, e cila duhet të përfshijë shpërblimin e Ofertuesit dhe të gjitha shpenzimet që mund të përballojë Ofertuesi për ofrimin e shërbimit të kërkuar.

** Vërtetimet mund të jepen në formën e një vetë-deklarate por Autoriteti Kontraktor rezervon shprehimisht të drejtën të kërkojë kopje origjinale apo të njësuara me origjinalin nga institucionet kompetente, në rast dyshimi mbi vërtetësinë e informacioneve të dhëna.*

VII. PROCEDURA E PËRZGJEDHJES

A. Komisioni për ndjekjen e procedurave

Komisioni për ndjekjen e procedurave (KNP), i ngritur me Urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat përkatëse të VKM 392/2009.

KNP përbëhet nga:

1. Zj. Brunilda Lilo (Kryetare)

Avokate Shteti

brunilda.lilo@avokaturashtetit.gov.al

2. Z. Marsel Sanxhaku (Anëtar)

Avokat Shteti

marsel.sanxhaku@avokaturashtetit.gov.al

3. Zj. Entila Jashari (Anëtare)

Avokate Shteti

entila.jashari@avokaturashtetit.gov.al

Komisioni, ndër të tjera:

- Përgatit dokumentacionin;
- Shpërndan ftesën për negociata;
- Jep sqarime mbi dokumentet e procedurës konkurruese;
- Bën vlerësimin e ofertave;
- Bën një raport të hollësishëm të mbi procedurën e ndjekur, të cilin ia dërgon Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, së bashku me klasifikimin e Ofertuesve.

Komisioni komunikon në anglisht me Ofertuesit.

B. Kërkesa për sqarim

Ofertuesit e interesuar mund të paraqesin kërkesa për sqarim në lidhje me këtë Ftesë për Negociata deri më datë 16.10.2014, ora 13.00 CET.

Kërkesat për sqarim duhet t'i dërgohen të gjithë anëtarëve të KNP dhe një kopje (cc) Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit në adresat zyrtare të e-mailit të përmendura më sipër.

C. Dorëzimi dhe hapja e Ofertave

Oferta me informacionin dhe dokumentet përkatëse duhet të dërgohet me postë të regjistruar në zarf të mbyllur me shënimin mbi të "Përfaqësimi i Ministrisë së Financave/Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në mosmarrëveshjen me Rapiscan System & S2 Albania SH.P.K."

Oferta duhet të dërgohen në adresën Avokatura e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, Blv. Zogu I, Tiranë, Shqipëri deri në datën 22.10.2014, ora 15.00 CET.

Ofertat do të hapen më datë 23.10.2014, ora 12.00 CET në prani të të gjithë anëtarëve të Komisionit.

D. Vlerësimi i Ofertave, shpallja e fituesit dhe procesi i ankimimit

Ekstrakt nga nenet 14 dhe 15 të VKM 392/2009:

"Pas analizimit të ofertave të paraqitura nga avokatët apo zyrat e avokatisë, vendase apo të huaja, komisioni përzgjedh, në bazë të pikëve, avokatin apo zyrën e avokatisë, vendase apo të huaj, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 13 dhe në ftesën për negociim.

"Brenda 2 ditëve nga përfundimi i procedurës së përzgjedhjes, komisioni harton një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, avokatët/zyrat e avokatisë që kanë marrë pjesë dhe avokatin/ zyrën e avokatisë së përzgjedhur, të cilin ia paraqet Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit së bashku me klasifikimin përfundimtar të avokatëve/zyrave të avokatisë sipas pikëve.

"Avokati i Përgjithshëm, në bazë të rekomandimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit, vendos, brenda 2 ditëve nga data e paraqitjes së rekomandimit dhe ia dërgon vendimin e tij për miratim Ministrisë së Drejtësisë, duke njoftuar njëkohësisht avokatët/zyrat e avokatisë që kanë marrë pjesë, si dhe organin e përfaqësuar.

"Organi i përfaqësuar mund të paraqesë me shkrim brenda tri ditëve te Ministri i Drejtësisë kundërshtimet e veta në lidhje me çmimin e shërbimit. Në rast se organi i përfaqësuar nuk paraqet kundërshtime me shkrim brenda këtij afati, çmimi i shërbimit konsiderohet i pranuar prej tij.

"Avokatët apo zyrat e avokatisë të interesuara mund të ankohen lidhur me procedurën e kontraktimit brenda 5 ditëve nga vendimi i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Ankesat për procedurën e kontraktimit paraqiten në çdo rast me shkrim dhe i drejtohen Ministrisë së Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë shprehet me vendim lidhur me ankesën, brenda 2 ditëve nga marrja e saj dhe njofton ankuesin dhe Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit me shkrim.

“Në përfundim, Ministri i Drejtësisë brenda 7 ditëve nga paraqitja e vendimit nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit miraton kontraktimin e avokatit/zyrës së avokatisë. Në rast se Ministri i Drejtësisë nuk përgjigjet brenda këtij afati, vendimi i kontraktimit konsiderohet i miratuar. Në vijim, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit lidh kontratën me avokatin apo zyrën e avokatisë, vendase apo të huaj, për kryerjen e shërbimit të përfaqësimit dhe të mbrojtjes”.

VIII. TË NDRYSHME

Lutemi të mbahet parasysh që :

- a) Ofertat dhe dokumentet e paraqitura jashtë afatit dhe jo në përputhje me këtë Ftesë për Negociata nuk do të merren parasysh;
- b) Ofertuesi nuk mund të tërhiqet nga Oferta e tij pas paraqitjes së saj;
- c) Tarifa e shërbimit nuk ndryshohet për asnjë arsye pas lidhjes së kontratës;
- d) Oferta nuk duhet të dërgohet me email pasi bëhet e pavlefshme;
- e) Tarifa e shërbimit nuk duhet të jetë me orë punë;
- f) Tarifa e shërbimit nuk duhet të përmbajë tarifë suksesi ;
- g) Autoriteti kontraktor ka të drejtë të ndërpresë këtë procedurë në çdo moment dhe asnjë dëmshpërblim nuk mund të kërkohet për një vendim të tillë të Autoritetit Kontraktor;
- h) Midis Autoritetit Kontraktor dhe ofertuesve nuk ka asnjë marrëdhënie kontraktore deri në nënshkrimin e një kontrate të shkruar.

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ALMA HICKA



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to read "Alma Hicka". The signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" at the top and "AVOKATURA E SHTETIT" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania, featuring a double-headed eagle.